



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.21/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore dyshuar për shkelje disiplinore me rastin e ndërmartjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 311/2020, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike me datën 30.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-21/2020, datë 09.11.2020, dhe ankesa e palës ankuese, të datës 26.10.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 311/20.

A r s y e t i m

Me datën 26.10.2020, pala ankuese, , ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat, i organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore për shkelje të Ligjit të Procedurës Përmbarimore sepse i njëjti ka tejkalluar autorizimet e tij dhe gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij nuk i është përmbaritur ligjit. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi privat në kundërshtim me dispozitat ligjore i kishte bllokuar llogaritë bankare të debitorit gjatë kohës së pandemisë edhe përkundër faktit se debitori

nuk ka operuar sepse e ka pasur të ndaluar operimin. Sipas palës ankuese, urdhërin për përmbarrim e kanë pranuar në punëtori me datën 12.03.2020 kurse me datën 13.03.2020 Qeveria e Republikës së Kosovës, ka marr vendimin mbi kufizimet e operimit të bizneseve. Sipas palës ankuese përmbarruesi privat subjekt i kësaj procedure disiplinore iu kishte bllokuar llogarinë bankare për një kohë të gjatë dhe më pas ka ekzekutuar shumën e caktuar ende pa e marr vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në fund, pala ankuese thekson se kishin humbur afatit për paraqitjen e prapësimit dhe kanë kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme, megjithatë, përmbarruesi ka vazhduar me përmbarrimin.

Me datën 09.11.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat _____ organ përmbarrues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore _____ lidhur me veprimet përmbarrimore në lëndën P. nr 311/20.

Përmbarruesi privat _____ në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje janë ndërmarr në pajtim me dispozitat ligjore dhe autorizimet që dalin nga ligji. Thekson se propozimi për përmbarrim është bërë me datën 12.04.2020 dhe në të njëjtën datë është lëshuar urdhëri përmbarrimor. Propozimi dhe urdhëri i janë dorëzuar debitorit në të njëjtën datë. Pas kalimit të afatit prej 7 ditësh, përmbarruesi tek pas ditës së 22-të, ka vazhduar me bllokimin e llogarive. Pala ankuese ka ushtruar prapësim por jashtë afatit ligjor. Tutje, përmbarruesi thekson se me datën 22.09.2020, është njoftuar me shkrim nga kreditori se kërkon tërheqjen e propozimit për përmbarrim sepse debitori drejtpërdrejt kreditorit i ka përmbushur detyrimin sipas propozimit ndërsa shpenzimet përmbarrimore i ka paguar kreditori. Me datën 23.09.2020, përmbarruesi thekson se ka nxjerr konkluzion për përfundimin e procedurës përmbarrimore dhe e ka njoftuar gjykatën lidhur me këtë parashtrësë për tërheqje. Për sa i përket Udhëzimit të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, përmbarruesi privat thekson se ai ka pasur karakter udhëzues për sa i përket përmbarrimit ku si palë ishin qytetarët por jo lidhur me bizneset. Rrjedhimisht, sipas përmbarruesit privat, organi përmbarrues nuk kanë pasur pengesa në bllokimin e llogarive bankare si në rastin konkret.

Me datën 30.12.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore. Znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat _____ luke theksuar se bazuar në ankesën e parashtruar nga pala ankuese, përmbarruesi privat ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarrimore në lëndën P.nr 311/20 duke shkelur ligjin dhe tejkalluar autorizimet ligjore.

Pala ankuese _____ nuk ka marr pjesë edhe pse i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe Komisioni nuk ka pranuar ndonjë njoftim lidhur me arsyet e mospjesëmarrjes.

Përmbaruesi privat ka prezentuar sqarimet përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij duke theksuar se ai ka vepruar në pajtim me ligjin dhe ka kërkuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar ankesën e paraqitur nga pala ankuese kurse në cilësi të provave ka administruar provat në vijim: Propozimin për përmbarim dt 12.03.2020; Propozimin për kthim në gjendje të mëparshme dt 18.05.2020, Prapësimin dt 10.05.2020; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr 01/09 lidhur me Pandeminë Covid-19, dt 13.03.2020; Fletëdërgesën për Dorëzim Personal të Urdhërit dt 12.03.2020; Urdhërin për Dërgim e të Dhënave Bankare dhe Bllokimin e Atyre Llogarive dt 03.04.2020; Përgjigjen në Prapësim dt 21.05.2020; Përgjigjen e Kreditorit në Propozimin e Debitorit për Kthim në Gjendje të Mëparshme dt 21.05.2020; Shënimin Zyrtar dt 05.06.2020; Parashtrësën e Kreditorit dt 22.09.2020; Urdhërin për Debllokim të Llogarive Bankare dt 22.09.2020 dhe Konkluzionin dt 23.09.2020.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë dhe se përmbaruesi privat nuk ka kryer vepër disiplinore.

Komisioni gjen se përmbaruesi privat kishte dorëzuar palës ankuese udhërin për përmbarim të cilën pala ankuese e kishte pranuar. Meqenëse pala ankuese nuk kishte përmbushur obligimin e tij, përmbaruesi privat kishte ndërmarr veprime për bllokimin e llogarive bankare. Bazuar në shkresat e lëndës, pala ankuese kishte ushtruar prapësim dhe kjo është proceduar në gjykatën kompetente. Prapësimi ishte jashtë afateve ligjore. Fakti se pala ankuese ka dështuar t'i përmbahet afatit për paraqitjen e prapësimit, nuk mund t'i atribuohet përmbaruesit privat si lëshim. Nëse kishte arsye të cilat përligjin humbjen e afatit, pala ankuese kishte mundësi që përmes mjeteve juridike të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme. Këtë e ka bërë pala ankuese në gjykatën kompetente. Përmbaruesi privat nuk kishte ndërmarr asnjë veprim tjetër derisa çështja ishte ende në gjykatë. Në ndërkohë, pala ankuese ka përmbushur obligimin në mënyrë të drejtëpërdrejt kreditorit. Përmbaruesi pas marrjes së njoftimit menjëherë ka bërë debllokimin e llogarive bankare dhe ka njoftuar gjykatën. Rrjedhimisht, Komisioni gjen se përmbaruesi privat kishte vepruar sipas autorizimeve.


Sa i përket çështjes së zbatimit të procedurës përmbarrimore gjatë kohës së Pandemisë kur Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendimin dt 13.03.2020 mbi kufizimet e operimit, Komisioni gjen se pala ankuese këtë pretendim e ka theksuar në kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme pranë gjykatës kompetente. Procedura pranë Komisionit nuk është procedurë instancionale ku palët ngrisin pretendimet e tyre për çështje juridike të cilat shqyrtohen nga ana e gjykatave në procedura ligjore. Palët kanë të drejtë të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion, siç edhe ka bërë pala ankuese, për të adresuar shqetësimet dhe pretendime e saj në procedura gjyqësore. Komisioni nuk është i thirrur t'i vlerësojë apo të jap komentime përkitazi me çështjet të cilat janë në shqyrtim pranë gjykatave. Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson se çështja e pretenduar nga pala ankuese përkitazi me zbatimin e procedurës përmbarrimore gjatë kohës kur ishte marr vendimi i

Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi kufizimet e operimit të bizneseve, nuk bie në kompetencë të kësaj procedure.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 21/2020, datë 30.12.2020.

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.